

**KLARA KODRA****LARMIA E STILEVE DHE BASHKËVEPRIMI MIDIS TYRE  
NË POEZINË TONË TË RE**

Metoda jonë e realizmit socialist si fazë më e lartë e parimit realist të pasqyrimin të jetës është e vetmja metodë që lejon lulëzimin e plotë të individualiteteve krijuese të papërsëritshme. Individualiteti krijues i një poeti shprehet në parimet e veçanta, individuale të organizimit të formës, karakteristike vetëm për të që pasqyrojnë këndin e tij të perceptimit të realitetit.

Rëndësia e një poeti qëndron pikërisht në fjalën e re që ai thotë, fjalë e re që nuk duhet të jetë qëllim në vetvete, po të shprehë interesat e gjera të shoqërisë, të japë pasqyrimin e një etape të veçantë të jetës së popullit, një aspekt të veçantë të kësaj jete që paraqet interes në një periudhë të caktuar. Poeti që të jetë vërtet origjinal duhet t'u përgjigjet prirjeve të caktuara të letërsisë së kohës së vet. Vlerësimi objektiv i origjinalitetit të një poeti lidhet me konceptimin e drejtë të raporteve midis traditës dhe novatores. Novatorizmi lind nga vijimi krijues i traditës, jo nga mohimi nihilist i saj.

Poezia e viteve '50 çante nëpër shtigje të pashkelura prandaj ajo nuk mund t'u shpëtonte disa të metave të rritjes, por thelbin e saj e formojnë prirja për trajtimin e temave të mëdha, pathosi qytetar, synimi drejt realizmit dhe nisën të dalin në dritë disa individualitete krijuese si Ll. Siliqi dhe K. Jakova. Si lloj i përshtatshëm për karakterin dhe tematikën e kësaj poezie një lulëzim njohu poema me subjekt. Kuptohet se kjo poezi nuk e kishte fituar ende aftësinë e plotë për të pasqyruar kontradiktat e shumta të realitetit tonë.

Në vitet e mëvonshme filloi një ndryshim cilësor në brendi e në formë në poezinë tonë të sotme që nisi të depërtojë në thellësi të realitetit të ri duke e dhënë atë jo më në vija të përgjithshme, po nëpërmjet tabllosh konkrete dhe figurash të gjalla heronjsh, duke synuar të riprodhonte dialektikën e shpirtit të njeriut tonë të ri dhe kontradiktat e jetës sonë, që u çlirua nga figuracioni konvencional dhe retorik duke krijuar një figuracion të ri të vetin dhe duke u afruar me burimin e gjallë të poezisë popullore.

Pikërisht në këtë kohë në poezinë tonë lulëzoi një larmi e madhe stileshe që tregonte gjallërinë e saj. Origjinaliteti i poetëve tanë më të mirë nuk lindi nga asgjëja; ai u rrit në truallin e begatshëm të traditës sonë përparimtare e revolucionare të së kaluarës të cilën ata nuk e imitojnë në mënyrë të verbër, po e çojnë më tej.

† Ndër individualitetet më të spikatur të poezisë sonë të sotme janë

Llazar Siliqi, I. Kadareja, D. Agolli dhe F. Arapi. Poezia e Llazar Siliqit lindi në një fazë tranzitore të jetës së poezisë sonë kur ajo luftonte kundër rutinës së vjetër e romantikës së rreme, retorikës klasikexhante dhe folklorizmit për të afirmuar një formë të re që do të shprehte përmbajtjen e re.

Poezinë e Llazar Siliqit e dallon karakteri agjitativ në kuptimin e mirë të fjalës. Heroi lirik i saj është tribun, orator që synon të gjejë të bukurën dhe heroiken në realitetin tonë e ta hymnizojë. Shpesh në këtë poezi vendin e figuracionit dhe të detajeve e zë fjala kushtruese e poetit. Pathosi politik i kësaj poezie është i fuqishëm.

Prirjes për të depërtuar në thellësi të ndjenjave dhe të mendimeve të njeriut të kohës ju janë përgjigjur në mënyrë të ndryshme I. Kadareja dhe D. Agolli.

Te I. Kadareja vëmë re synimin për të demaskuar me mprehtësi të vjetrën dhe për të afirmuar të renë në jetë që në embrion, për të trajtuar probleme të mëdha e të mprehta politike.

Poezia e Kadaresë është poezi mendimi më tepër se sa ndjenje; lirizmi në të shkrihet me epizmin dhe forca sintetike është e madhe.

Një vend të veçantë në këtë poezi e zë ironia që poeti e përdor si armë kundër botës së vjetër. Në demaskimin e së vjetrës poeti përdor me sukses edhe groteskun. Karakteristike për poezinë e Kadaresë janë figurat simbolike me proporcione të mëdha që shprehin gjerësinë e mendimit.

Figura të tilla janë «malet që... mendohen», «rrapi vigan...» që «ka mbirë anës udhës ku shkojnë shtërngatat» dhe që simbolizon Partinë.

Heroi i Kadaresë është kryesisht intelektual i ynë i ri dhe, në plan të gjerë, njeriu i kohës sonë. Ai dallohet për një botë të pasur shpirtërore që e shpalos në bisedë të hapur me lexuesin.

Fjalori poetik i Kadaresë është veçanërisht i begatshëm. Kadareja ka mundur të ngrejë në poezi shumë fjalë të teknikës moderne.

Novatorizmit të brendisë së poezisë së tij i përshtatet vargu i çli-ruar nga rregullat e metrikës tradicionale, po jo edhe nga ritmi dhe shpesh as nga rima.

Nganjëherë kërkimi i origjinalitetit me çdo kusht e shtyn poetin të ndikohet nga simbolizmi dhe impresionizmi dhe të krijojë figura të errta që e zhdukin mendimin në vend që t'i japin forcë.

Në një mënyrë tjetër e pasuron tabllonë e individualiteteve krijuese të poezisë sonë D. Agolli duke sjellë një lirizëm të ngrohtë, një begati të madhe ndjenjash dhe një frymë më të theksuar kombëtare. Për poezinë e D. Agollit mund të parafrazonim fjalët e po këtij poeti për Naimin, vargjet e tij «me thërrimet e dheut janë shkrire». D. Agolli depërton në mendimet dhe ndjenjat e fshatarit tonë të ri, po edhe të intelektualit të dalë nga radhët e fshatarësisë.

Në poezinë e tij detajet konkrete mbizotërojnë mbi figuracionin, ndjenja mbi mendimin. Agolli është mjeshtër i detajit me anë të të cilit shpesh krijon një tablo të tërë. Poeti trajton më tepër probleme shoqërore duke vënë në qendër të vëmendjes temën e jetës së përditshme të njeriut të thjeshtë. Një veçori e individualitetit krijues

të D. Agollit është prirja për të zbuluar poetiken në të zakonshmen. Gjuha e poezisë së tij është në mënyrë të veçantë e qartë dhe e kuptueshme; ai e pasuron fjalorin e vet poetik me fjalë dhe shprehje popullore.

F. Arapi e trajtoi temën qytetare duke e zgjeruar gamën tematike të saj me temën e klasës punëtore e cila trajtohet megjithatë kryesisht në plan të jashtëm dhe në aspektin e saj industrial. Heroi i poezisë së F. Arapit është në përgjithësi një hero intelektual dhe ndofta kjo e ka penguar poetin të hyjë në thellësi të temës së klasës punëtore. Nga kjo temë poeti sheh vetëm disa anë të caktuara që spikasin më tepër.

F. Arapi është poet i meditacionit, po poezia e tij s'ka mundur t'i largohet një farë cerebralizmi dhe hermetizmi. Në përgjithësi poezisë së Arapit i mungon spontaneiteti dhe kjo ka përcaktuar një farë ftohtësie të saj.

Këta poetë janë secili novator në mënyrën e vet, thonë fjalën e tyre të re në poezinë tonë, duke e pasuruar këtë poezi, secili sipas talentit e prirjeve të veta estetike, sipas mënyrës së vet të perceptimit të botës. Në qoftë se I. Kadareja solli një brendi të re, e çliroi formën nga konvencionet dhe shtampat e vjetëruara, nga rutina e poezisë romantike dhe retorizmi, e përtëriu vargun dhe fjalorin poetik, çeli një traditë që do të ndiqej nga shumë poetë të tjerë, D. Agolli nis një rrugë të re në drejtim të prirjes së një afrimi më të madh me lexuesin dhe të shfrytëzimit të poezisë popullore. Që të gjithë këta u mbështetën në tabanin e traditës sonë të shëndoshë të së kaluarës të cilën e çuan më tutje duke e mohuar dialektikisht.

Ll. Siliqi ndjen ndikimin e traditës romantike përparimtare e revolucionare, traditën e Mjedës dhe të Migjenit, po vetëm në një pjesë të poezisë së tij. Me të rrallë merr ndonjë motiv popullor ose përdor vargun popullor. I. Kadareja mbështetet në mënyrë krijuese te De Rada e Migjeni duke marrë nga i pari thellësinë e nëntekstit dhe lirizmin, nga i dyti guximin në perceptimin figurativ të botës. Nga poezia popullore poeti merr sporadikisht ndonjë motiv të cilin e përpunon në mënyrë krijuese.

D. Agolli dallohet për një mbështetje më të thellë në poezinë popullore nga e cila merr filozofinë, ngrohtësinë lirike, tonin e një bisede të shtruar, humorin e lezeçëm, shpesh vargun dhe figuracionin.

F. Arapi vijon traditën e Kadaresë në prirjen për meditime filozofike dhe figuracionin e guximshëm si edhe në vargun e lirë duke u përpjekur t'i thellojë e t'i ndërlikojë të gjitha këto, po shpesh tek ai prirja për nëntekst të pasur shndërrohet në errësirë, figuracioni bëhet i pakuptueshëm dhe i ftohtë.

Traditën e D. Agollit e vazhdon V. Ziko duke vënë në qendër të poezisë së vet temën e njeriut të thjeshtë dhe duke u mbështetur në poezinë popullore. V. Ziko ka prirje të pasqyrojë kontradiktat në ndërgjegjen e njeriut tonë.

Një shkrirje të traditave të themeluara nga I. Kadareja dhe D. Agolli e vëmë re në poezinë e Agim Shehut i cili merr nga poeti i parë prirjen për meditime dhe figuracione simbolike, llojin e poe-

mës dhe të vargut, po afrohet me të dytin në prirjen për të shfrytëzuar në mënyrë krijuese poezinë popullore duke marrë prej saj forcën komunikuese, thjeshtësinë dhe humorin e mprehtë.

Pati gjithashtu shumë poetë të rinj që u tërhoqën nga forca e mendimit dhe e sintezës, nga pasuria dhe karakteri i guximshëm i figuracionit të poezisë së Kadaresë dhe u ndihmuan prej tij në krijimtarinë e vet. Në përgjithësi poezia e Kadaresë ndikoi mbi ta në drejtim të thellimit të lirizmit dhe prirjes shumë pozitive për të medituuar mbi realitetin duke zbuluar logjikën e brendshme të fenomeneve, po nganjëherë kjo poezi ushtroi edhe ndikim negativ në drejtim të figuracionit të ndërlikuar e të errët.

Prej këtyre të rinjve mjaft poetë po e afirmojnë individualitetin e tyre krijues.

Kështu poezia e Ndoc Gjetjes është një poezi që priset nga zbulimi i poetikës në jetë dhe trajtimi i saj përmes një lirizmi shpërthyes ku mbizotëron ndjenja mbi mendimin dhe një figuracion i guximshëm; poezia e N. Lakos është poezi e koncizitetit lapidar dhe e figurave të pakta e thellësisht spontane, poezia e N. Papekës është poezi e pasurisë së përshtypjeve nga jeta, të cilat shtjellohen përmes një dialogu të sinqertë me lexuesin; poezia e S. Matos është poezi e tablove të pikturuara me hijeshi të realitetit tonë; poezia e S. Dedes është poezi që pasqyron fakte përmes detajesh të goditura së cilës i mungon pothuajse fare figuracioni:

Gjatë kërkimeve të poetëve ndodh fenomeni i epigonizmit i cili është një bashkëudhëtar i përkohshëm dhe i mërziqshëm i poezisë. Epigonizmi lind nga imitimi servil i traditës që do të thotë sipas shprehjes së Çernishevskit «duke mos qenë i zoti të rijapësh bukurinë e origjinalit... të riprodhosh në shkallë të gjerë të metat e saj duke i marrë për bukuri». Me epigonizmin lidhet edhe lindja e rutinës në poezi.

Një fenomen negativ që ndodhi kohët e fundit që mohimi nihilist i traditës nga ana e letrarëve të rinj të cilët hidhnin poshtë edhe vlerat e krijuara me kohë nga poezia jonë si frymën kombëtare të saj dhe harmoninë e vargut. Lindën kështu shfaqje të një pseudonovatorizmi që të renë e kërkonte vetëm në formë, duke ja sakrifikuar shpesh brendinë e kësaj të fundit dhe, si rrjedhim, një pjesë e letrarëve tanë filluan të krijojnë një poezi të errët, të pakuptueshme, ku shpesh figura është qëllim në vetvete duke u shkëputur kështu nga populli.

Poezia jonë po i le prapa si shfaqjet e epigonizmit ashtu edhe shfaqjet e shkëputjes së plotë metafizike nga tradita. Vitaliteti i poezisë sonë të sotme shprehet në larminë e jashtëzakonshme të individualiteteve krijuese edhe nga radhët e letrarëve të rinj.

Këto individualitete krijuese bashkëveprojnë në mënyrë aktive duke i dhënë secili tjetrit diçka nga e vetja në rrethin e motiveve, në figuracion, në mjetet e tjera shprehëse, në varg dhe duke mbetur secili në vetvete i veçantë dhe i papërsëritshëm, me këndin e vet të vështrimit të botës. Poezia e tyre i ka rrënjët thellë në traditat më të shëndosha të krijuara nga poezia jonë reflekse dhe popullore.

*R é s u m é*LA VARIÉTÉ DE STYLES ET LEUR COLLABORATION  
DANS NOTRE NOUVELLE POÉSIE

La Kodra a soumis à analyse, dans sa communication: *La variété de style et leur collaboration dans notre nouvelle poésie*, les différentes étapes qu'a franchies notre poésie, les individualités créatives les plus saillantes et la **collaboration** entre elles. Au centre de sa communication est la question de la tradition et de l'innovation en poésie, celui des rapports entre ces deux courants.

La Kodra fait ressortir les rapports étroits entre la tradition et l'innovation de poètes singuliers, sur l'action mutuelle entre eux et sur ce qu'ils ont donné les uns aux autres.

Dans cette communication est considéré aussi le problème de l'épigonisme, comme un phénomène transitoire dans notre poésie.

Enfin, la Kodra, formule quelques conclusions sur l'état actuel des styles dans notre poésie.

*[The page contains extremely faint, illegible text, likely bleed-through from the reverse side of the document. The text is mirrored and difficult to decipher.]*